



TË DHËNAT PËR PROJEKT

KOSOVË

Në gjithë Kosovën

JANAR – DHJETOR 2021

DEMOKRACI PLUS (D+)

Monitorimi i tenderëve publik të nënshkruar gjatë vitit 2020 dhe 2021 përmes procedurës së negociuar dhe ekspozimi i gjetjeve në raportet e monitorimit, përmes paraqitjeve në media, komunikimeve me zyrtarë përkatës nga institucionet publike dhe ofrimi i rekomandimeve për të njëjtit.

DONATOR

[Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë](#)

PËRMBLEDHJE

Për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia, e cila kishte filluar në tremujorin e parë të vitit 2020, shumica e institucioneve të nivelit lokal dhe qendror iniciuan procedurat e negociuara të prokurimit, duke i ftuar të ofertojnë vetëm një numër të vogël të kompanive, pa u ndjekur kështu rregullat e konkurrencës. Kontratat e negociuara eliminojnë konkurrencën te bizneset, ndërsa në rastet më skandaloze rezultojnë edhe mijëra apo miliona euro që dyshohet se janë abuzuar ose keqpërdorur në emër të luftimit të pandemisë. Edhe pse Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) ua ka dhënë dritën jeshile institucioneve publike për ta ndjekur procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë, ky proces kërkon monitorim dhe mbikëqyrje nga institucionet publike përkatëse, për t'i zbuluar kështu shkeljet e mundshme ligjore.

Në këtë kontekst, Demokraci Plus (D+) do të monitorojë disa tenderë të nënshkruar gjatë vitit 2020 dhe 2021. Gjetjet nga ky hulumtim do të paraqiten përmes dy raporteve të monitorimit, një raport për gjetjet që lidhen me tenderët e vitit 2020 dhe tjetri për gjetjet për kontratat që do të lidhen deri në fund të vitit 2021. Për më tepër, D+ do të monitorojë aktivitete prokurimi në katër komuna (Gjakovë, Gjilan, Podujevë, Mitrovicë), me ç'rast gjetjet e dala nga hulumtimi do të publikohen në një raport të veçantë. Në këtë mënyrë, D+ do të ofrojë rekomandime shtesë për të ndryshuar disa pjesë të legjislacionit që lidhen me transparencën dhe llogaridhënien. Gjithashtu, D+ do të organizojë disa takime avokimi me zyrtarë nga institucionet publike, do të zhvillojë një fushatë sensibilizuese për t'i informuar qytetarët mbi ndikimin e korrupsionit në jetën e tyre të përditshme dhe mënyrën se si shpenzohen taksat e tyre nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal, do ta lansojë një video të animuar në lidhje me koston e korrupsionit dhe do të publikojë infografika për të njëjtin qëllim, etj.

OBJEKTIVI KRYESOR

Dhënia e kontributit në zbulimin e mangësive të ndërmarrjes së hapave institucional për ta luftuar pandeminë COVID-19 përmes legjislacionit të ri dhe kontratave publike.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

OS1. Dhënia e kontributit në ndryshimin e ambientit kulturor dhe identitetit politik, në kuptimin e ndryshimit të vlerave shoqërore kundrejt sundimit të ligjit, korrupsionit, gjinisë dhe diskriminimit etnik;

OS2. Nxitja e diskutimit kolektiv për të arritur një konsensus të përbashkët mbi standardet kombëtare në angazhimin kundër korrupsionit dhe formave tjera të abuzimit shoqëror dhe shkeljeve të të drejtave;

OS3: Dhënia e kontributit në prishjen e rrjeteve që janë të prirura drejt korrupsionit dhe nga ana tjetër forcimin e pjesëmarrjes qytetare dhe llogaridhënies së zyrtarëve ndaj votuesve të tyre.

AKTIVITETET KRYESORE

- Monitorimi i punës së institucioneve publike në fushat e qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies, shpenzimeve publike dhe prokurimit publik:
 - Të paktën dhjetë (10) tenderë nga viti 2020 dhe dhjetë (10) tenderë të vitit 2021 do të analizohen në kuadër të reagimit ndaj pandemisë, të cilat janë kryer përmes procedurës së negociuar;
 - Dy raporte monitorimi mbi kontratat e dhëna publike gjatë pandemisë COVID-19 në vitet 2020 dhe 2021;
 - Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve të prokurimit në katër komuna
 - Një raport monitorimi mbi gjetjet e dala nga monitorimi i drejtpërdrejtë i tenderëve në komunat e synuara.
- Monitorimi dhe dhënia e kontributit në politikëbërje më të mira përmes propozimit të rekomandimeve dhe përfshirjes në hartimin e ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative në nivelin qendror dhe lokal në fushat e qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies, shpenzimeve të parave publike dhe prokurimit publik:
 - Lëshimi i gjashtë (6) reagimeve të shpejta ndaj vendimeve që Qeveria dhe institucionet publike i ndërmarrin në emër të parandalimit të pandemisë COVID-19;
 - Ofrimi i rekomandimeve për të paktën dhjetë (10) plotësime/ndryshime të legjislacionit primar dhe sekondar në lidhje me qeverisjen qendrore dhe lokale, qeverisjen e mirë, transparencën dhe llogaridhënien.
- Ekspozimi i rasteve të korrupsionit dhe keq menaxhimit të fondeve publike dhe raportimi i tyre në media, përmes opinioneve dhe editorialeve, blogjeve dhe paraqitjeve në media:
 - Një video e animuar që ka të bëjë me koston e korrupsionit, duke theksuar gjetjet kryesore të të gjithë projektit;
 - Organizimi/mbajtja e rreth 50 paraqitjeve në media përmes intervistave dhe pjesëmarrjes në debate televizive ose artikujve në media, në portalet online, gazetat e shtypura dhe TV;
 - Rreth 20 takime me qëllim avokimi, takime të cilat synojnë të ngrisin çështje të identifikuara me institucionet publike dhe organizatat tjera të shoqërisë civile;

- Kryerja e një fushate sensibilizuese për t'i informuar qytetarët mbi ndikimin e korrupsionit në jetën e tyre të përditshme dhe mënyrën e shpenzimit të taksave të tyre nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal.

GRUPET E SYNUARA

- Qeveria (Zyra e Kryeministrit)
- Katër komunitat e përzgjedhura: Gjakovë, Gjiilan, Podujevë dhe Mitrovicë
- Organi Shqyrtues i Prokurimit
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- Kuvendi dhe komisionet relevante
- Ministria e Shëndetësisë
- Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
- Publiku i gjerë
- Mediat

IMPLEMENTUESI KRYESOR I KONTRATËS

Demokrasi Plus (D+)

./.